



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

KËSHILLI I BASENIT UJËMBLEDHËS SEMAN

VENDIM

Nr.16 datë 07.02.2020

PËR

MIRATIMIN E LEJES PËR HAPJEN E NJË PUS SHPIMI PËR UJË TË PIJSHËM, BASHKIA KORÇE QARKU KORÇË, ME KËRKESE TË KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË.

Në mbështetje të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.111/2012, i ndryshuar me ligjin 6/2018, datë 8.2.2018, për "Menaxhimin e integruar të burimeve ujore" VKM nr. 221, datë 26.4.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore ", si dhe të VKM Nr.416, datë 13.5.2015 si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 6 datë 12.6.2019, "Për miratimin e rregullores", "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor" "Për pajisjen me leje të këtij pus-shpimi me propozim të Z.A.B.U. Shkumbin-Seman.

Këshilli i Basenit Ujor Seman

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim, për përdorim të burimit ujor të pus shpimit, me qëllim përdorimi për ujë të pijshëm në Bashkinë Korçë, Qarku Korçë
2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin-Seman për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Baki BALA

